



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:200778

Datë: 27.02.2023

Numri i dokumentit: 04019462

C.nr.2054/13

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, Sheshi “Nëna Terezë”, numër 36, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Izet Rexha, jurist pranë paditëses, kundër të paditurit F.D, nga Prishtina, Rruga “Dervish Shaqa” (Kolovicë e Vjetër), me objekt kontesti kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 528.96€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të datës 16.02.2023, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të të paditurit, me datë 27.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë.
- II. DETYROHET i padituri F.D, nga Prishtina, që në emër të dëmit material të shkaktuar, paditëses t’ia paguaj shumën prej 528.96€ (pesëqind e njëzet e tetë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent), me kamatë si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit pa destinim të caktuar, prej nga data e ushtrimit të padisë në Gjykatë, 26.08.2013, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.
- III. DETYROHET i padituri F.D, nga Prishtina, që paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 15.00€ (pesëmbëdhjetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij

aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, me datë 26.08.2013, në këtë Gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit F.D, nga Prishtina, për kompensimin e dëmit material.

Paditësja, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, në padi, seanca gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i padituri nga data e pa vërtetuar e deri me datë 09.03.2009, në shtëpinë e tij me qëllim që ti sjell vetës pasuri të paligjshme, në mënyrë të kundërligjshme dhe të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, me çka paditëses i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 528.96€. Për këtë ekziston edhe aktgjykimi penal me shenjën P.nr.845/09 i Gjykatës Komunale në Prishtinë, me të cilën i padituri është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale vjedhje. Gjykata, palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës së sajë e ka udhëzuar në kontest civil. Mbi bazën e kësaj i ka propozuar Gjykatës që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, ta detyrojë të paditurin që paditëses t'ia paguaj dëmin e shkaktuar, me kamatë ligjore nga data e ushtrimit të padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 15.00€, në emër të taksës gjyqësore për padi.

I padituri F.D, nuk ka dhënë përgjigje në padi dhe nuk ka prezantuar në seancën përgatitore si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, të cilat janë mbajtur në mungesë të të paditurit, konform dispozitës së nenit 409, paragrafi 2 dhe nenit 423, paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK).

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palës paditëse, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat relevante dhe atë: Fatura me numër D....., i datës 18.03.2009, Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë me shenjën P.nr.845/09, i datës 22.02.2011 dhe Transaksionet e konsumatorit me numër D....., i datës 24.10.2022, lëshuar nga KES-Co.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), gjeti se në këtë çështje juridike kontestimore kërkesëpadia e paditëses është e bazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, bazuar në provat materiale të administruara si më lartë, ka gjetur se i padituri F.D, konsumator i të paditurës me numër të njehsorit D....., nga data e pa përcaktuar e deri me datë 09.03.2009, paditëses i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 528.96€. Dëmi është shkaktuar nga shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike, i cili ka ndodhur në shtëpinë e të paditurit, ashtu që i padituri në mënyrë të paautorizuar ka bërë lidhjen direkte në rrjetin e tensionit të ulët pa njësor elektrik, me kabull në seksion 2.5mm, dhe energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, fakt ky që provohet edhe me vërtetimin e divizionit të shpërndarjes, me shenjën 122969, i datës 22.04.2010 si dhe me aktgjykimin P.nr.845/09, të datës 22.02.2011, të ish Gjykatës Komunale në Prishtinë, i formës së prerë nga data 27.01.2012. Paditësja, me datë 18.03.2009, për dëmin e pësuar ka lëshuar faturën me shenjën DPR09HP07470, për kthimin e humbjeve, e cila faturë nuk është provuar që është kundërshtuar nga pala e paditur.

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore baza juridike e kërkesëpadiës është në dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 (gazeta zyrtare RSFJ numër 29, 26 maj 1978), i cili ligj ka qenë i zbatueshëm në kohën e shkaktimit të dëmit.

Me dispozitën e nenit 154, paragrafi 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978 (gazeta zyrtare RSFJ numër 29, 26 maj 1978), është përcaktuar se: “Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.” Ndërsa me nenin 185, paragrafi 1 dhe 2 të ligjit të njëjtë është përcaktuar se: “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla.”

Gjykata, bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, provat materiale të administruara në këtë çështje juridike kontestimore dhe deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, ka gjetur se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses, në vlerë prej 528.96€. Andaj në mes palëve është krijuar raport detyrimor, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit, kurse e paditura e ka cilësinë e

debitorit, ashtu që bazuar në nenin 245, paragrafi 1, i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku është përcaktuar se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.” dhe paragrafin 2, të ligjit dhe nenit të lartcekur, ku është përcaktuar se: “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonon me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”, siç edhe ka kërkuar paditësja në këtë rast.”

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 277 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të vitit 1978.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 449 dhe 452 të LPK-së e që në rastin konkret i referohen shpenzimeve për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 15.00€.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.2054/13, datë 27.02.2023.

Gjyqtari
Nexhat Qallapeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi
palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve,
nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit,
përmes kësaj Gjykate